**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Kreshnik Spahiu** | **24.11.2023** | **01.12.2023** | **2023/0908** |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë: 16.11.2023, Operatori Ekonomik ( më tej OE) “" VIBTIS " Dega në Kosovë”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0908, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik “D&T Group” SH.P.K.; KOSOVA MOTORS J.S.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me numër të prokurimit: "616-23-7016-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (më tej AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. AK ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 1,500,000.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**Dispozitat e shkelura**

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 – Provat shkresore

Neni 68 - Gjendja Ekonomike dhe Financiare Udhëzuesi Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik - Shënim për kërkesat e gjendjes ekonomike dhe financiare (neni 68 i LPP-se)

**Pretendimet ankimore**

I. HYRJE

1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës (tutje referuar si: "Autoriteti Kontraktues"), ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datë 14.07.2023, përmes të cilit ka kërkuar dorëzimin e ofertave për pajisje për pastrimin e kryeqytetit me 4/4 titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit" dhe me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1. 2. VIBTIS Dega në Kosovë (tutje referuar si: "Ankuesi"), brenda afatit të përcaktuar në dosjen e tenderit ka dorëzuar ofertë, duke i plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

3. Me datën 06.09.2023 në orën 14:00 është bërë hapja e ofertave dhe leximi çmimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ky raport është publikuar me datë 07.09.2023 i nënshkruar nga Zyrtari i Prokurimit. Nga raporti i hapjes dhe leximi i çmimeve kemi kuptuar se në këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar gjithsej 4 (me fjalë: katër) oferta nga operator të ndryshëm ekonomik.

4. Me datën 04.10.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktues kemi pranuar Dokumentin B58 Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin kemi kuptuar se oferta ynë është refuzuar kinse si e papërgjegjshme. Kjo ishte arsyetuar kinse Ankuesi nuk përmbush kriterin e dosjes së tenderit për sa i përket Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nr. I neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional 1. në të cilin ishte kërkuar si në vijim: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjajshme me vlere minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë.

5. Sipas të dhënave të ofruara në Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, thuhet se kinse qarkullimi specifik i Ankuesit është në vlerë prej 1,903,196.70 Euro dhe jo 2,000,000 Euro siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Autoriteti kontraktues nuk është treguar i kujdesshëm për të vlerësuar ofertat sipas të dhënave në dokumentet e shqyrtuara, pasi që ka injoruar faktin se të dhënat për qarkullimin janë pa përfshirë Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (tutje referuar si: TVSH), gjë e cila është rregull e përgjithshme në procedurat e prokurimit kudo në Europë, pasi që kërkesat e Direktivës 2014/24 kërkojnë që ofertat në prokurim publik të dorëzohen pa TVSH. Sidoqoftë, kjo nuk e ndryshon faktin se të gjitha faturat dorëzohen dhe paguhen duke përfshirë TVSH-në, sipas normës së aplikueshme për artikullin e caktuar. Në anën tjetër, në Kosovë sipas Ligjit të aplikueshëm për Prokurimin Publik, çmimet e kontratave dhe ofertat dorëzohen duke përfshirë TVSH-në. Kjo krijon ndonjëherë keqkuptime dhe/apo keqinterpretime në shqyrtimin e dokumentacionit sa i përket qarkullimit dhe qarkullimit specifik të operatorëve ekonomik siç është rasti i kësaj ankese, ku Komuna e Prishtinës nuk ka marrë për bazë normën prej 20% të TVSH-së e cila aplikohet në Shqipëri.

6. Për më tepër, nga qasja në dokumente publike sipas Nenit 10 të Ligjit të Prokurimit Publik, kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator të papërgjegjshëm, i cili nuk ka dorëzuar qarkullim sipas natyrës së kontratës, por qarkullimi i tij është në fushën e makinerisë bujqësore, pra makineri dhe mekanizma të bujqësisë dhe jo siç është kërkuar me Dosjen e Tenderit (natyrës së kontratës për pajisje të pastrimit).

7. Për këtë arsye me datë 09.10.2023 kemi paraqitur Kërkesën e parë për Rishqyrtim, me të cilën kemi argumentuar se dy operatorë në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, nuk i

plotësojnë kushtet e dosjes së tenderit, njëri për shkak të qarkullimit i cili nuk ishte në natyrën e kontratës e tjetri për shkak të produktit me të cilin kishte aplikuar nuk ishte në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe se i njëjti kishte modifikuar katalogun për pajisjet e prodhuesit FORD i cili nuk përkonte me të dhënat zyrtare të prodhuesit të publikuara në webfaqe të prodhuesit. Për të njëjtën procedurë Kërkesë për Rishqyrtim kishte paraqitur edhe operatori D & T Group ShPK.

8. Autoriteti Kontraktues ka aprovuar Kërkesën për Rishqyrtim të operatorit D & T Group SHPK dhe ka kthyer lëndën në Rishqyrtim, por ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim të VITBIS Dega në Kosovë. Pretendimet ankimore të Ankuesit nuk janë trajtuar meritorisht, pasi që sipas Autoritetit Kontraktues, Ankuesi ishte palë pa interes. Edhe pse kjo është e pavërtetë dhe e pabazuar me provat e siguruara dhe ligjin e aplikueshëm, përsëri Autoriteti Kontraktues është dashur të sigurohet në procedurë të rivlerësimit se pretenimet për modifikim katalogu dhe qarkullim jashtë natyrës së kontratës, bien në kundërshtim me kushtet e tenderit dhe me ligj.

9. Pas rivlerësimit të lëndës me datën 27.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues sipas rivlerësimit të ofertave me çka ka rekomanduar për dhënie të kontratës konsorciumin D & T Group SHPK dhe Kosova Motors JSC. Këtë vendim autoriteti e ka marrë pavarësisht se paraprakisht ishte njoftuar se oferta e të njëjtit është e papërgjegjshme dhe se duhej eliminuar. 10. Me datë 01.11.2023 Ankuesi ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim duke përsëritur pretendimet se ofertat e dy operatorëve ekonomik janë të papërgjegjshme bazuar në kushtet e dosjes së tenderit dhe se të njëjtat duhet të eliminohen. Me datë 06.11.2023 U.D. Udhëheqësi i Sektorit të Prokurimit në kuadër të Autoritetit Kontraktues ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar si të pabazuar duke refuzuar të trajtoj sërish pretendimet e Ankuesit

II. ELIMINIMI I VIBTIS ËSHTË I KUNDËRLIGJSHËM DHE OFERTAT DUHET TË RIVLERËSOHEN

11. Nga arsyetimi i Autoritetit Kontraktues të publikuar në Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, thuhet se kinse qarkullimi specifik i Ankuesit është në vlerë prej 1,903,196.70 Euro dhe jo 2,000,000 Euro siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. 12. Së pari duhet të sqarohet se të gjitha të dhënat e paraqitura në Aneksin 6, janë dhënë pa përfshirë vlerën e TVSH e cila në Republikën e Shqipërisë është 20 përqind. Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë në konsideratë këtë dhe këto vlera i ka kalkuluar pa marrë parasysh këtë fakt. Në këtë mënyrë ka ardhur deri tek konstatimi i gabuar se Ankuesi nuk i plotëson kriteret e qarkullimit specifik në vlerë prej 2,000,000 Euro. Ankuesi për OSHP-në dhe ekspertin do të vejë në dispozicion faturat e dorëzuara tek autoritetet kontraktore që dëshmon se pagesat janë bërë duke shtuar vlerën e TVSH-së dhe se qarkullimi në këtë mënyrë është shumë më i lartë sesa vlera 2,000,000 Euro. (Shih të bashkangjitur si provë dy fatura si shembull ku tregohet se TVSH i është paguar operatorit. Ankuesi sipas nevojës në OSHP mund të sjellë të gjithë setin e të dhënave me secilën faturë nga kontratat/referencat e dorëzuara).

13. Në Ligjin Nr. 162/2020 për Prokurimit Publik të Republikë së Shqipërisë Neni 34, Paragrafi 1 thuhet: "Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti 6/4 kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet ti mbajë ato parasysh

kur përllogarit vlerën e prokurimit." Kjo dispozitë është në përputhje me Direktivën 2014/24 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 26.02.2014 për Prokurimin Publik.

14. Autoriteti Kontraktues ka injoruar sqarimet e ofruara në Aneksin 6 të dorëzuar me listën e kontratave të përfunduara, ku është sqaruar se të gjitha shifrat e ofruara janë pa përfshirë TVSH-në. Andaj, ky eliminim është i paligjshëm, duke marrë në konsideratë se po ti shtohet vlerës 1,903,196.70 Euro TVSH me normë 20 përqind, atëherë jo vetëm se arrihet kërkesa për qarkullim specifik prej 2,000,000 Euro, por edhe tejkalohet ajo. Autoriteti Kontraktues, do të duhej ta marrë në konsideratë këtë fakt për të rivlerësuar ofertat e dorëzuara dhe për të pranuar ofertën e Ankuesit si të përgjegjshme. Të paktën që Autoriteti Kontraktues është dashur ta bëjë është kërkesa për sqarime dhe të vlerësoj drejtë gjendjen faktike

III. OFERTA E KONSORCIUMIT TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË ËSHTË E PAPËRGJEJSHME PËR OFRIM TË DHËNAVE TË PASAKTA SI DHE OFERTIM ME DY PRODHUES TË NDRYSHËM

15. Siç është bërë e ditur në Kërkesën për Rishqyrtim, Konsorciumi i udhëhequr nga D&T Group ka ofertuar me dy brande të ndryshme, njëri brand është Ford dhe tjetri OTOKAR. Në Dosjen e Tenderit është kërkuar shprehimisht që: "Të gjitha automjetet e ofruara (shasi) të prodhuara nga i njëjti prodhues/ 12.Deklaratë nga prodhuesi se të gjitha automjetet e ofruara (shasi) prodhohen nga i njëjti." Ky konsorcium është munduar që këtë të arsyetoj me një dokument i cili quhet "Shareholder Statement" në të cilin thuhet se aksionar kryesor për Otokar është FORD Otosan. Mirëpo, Dileri i Autorizuar i këtij ofertuesi është Albanian Motor Company Shpk, i cili ka autorizim nga ana e FORD LLC dhe jo FORD Otosan. Autorizimin për mjete TRUCK duhet te ishte nga prodhuesi FORD OTOMOTIV SANAYI A.S (FORD OTOSAN). Këto dy kompani janë entitete të veçanta dhe autorizimi i tillë nuk mund ti pranohet ofertuesit D&T Group. Andaj, komisioni për vlerësimin e ofertave është dashur që ta eliminoj këtë ofertë. Autoriteti Kontraktues nuk i ka shqyrtuar këto pretendime dhe për rezultat ka rekomanduar për dhënie një operator të papërgjegjshëm. Do të thotë oferta e rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kriterin që pajisjet të jenë nga i njëjti prodhues. Në rastin përkatës aksionarët e kompanisë mund të jenë të njëjtë por jo edhe kompania prodhuese. Në këtë rast për këtë arsye OSHP duhet ta eliminoj këtë ofertë si të papërgjegjshme. Kjo konfirmohet

16. Për më tepër duhet thënë se produktet e prodhuesit FORD nuk plotësojnë kërkesat e specifikacioneve teknike siç janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe konsorciumi i udhëhequr nga D&T Group ka ndryshuar këto specifika në të dhënat që i ka paraqitur për vlerësim të ofertave për Autoritetin Kontraktues. Në vijim ne do të paraqesim pasaktësitë të cilat i kemi identifikuar në katalogun e D&T Group dhe të cilat janë të pasakta: a. Ulja e Volumit të motorit – E kërkuar 7-8 L është ndryshuar në 7984 cc (Reale 8974 CC) b. Numri i marsheve – e kërkuar 6 +1 – Është ndryshuar në 6+1 (Reale është 9+1) c. Wheel Base – E kërkuar 4300-4400 mm – E ndryshuar në 4300 mm (Reale 4250 mm) d. Ndryshimi i depozitës së naftës – E kërkuar Plastike – e ndryshuar Plastike (Reale Alumin).

17. Po ashtu pasaktësi janë identifikuar edhe në shasinë e ofruar OTOKAR ATLAS 12T, si në vijim: a. Pesha në Aksin e parë – E kërkuar min. 4 Ton – e ndryshuar në 4 Ton – (Reale 2.9 Ton) b. Pesha në Aksin e Dytë – E kërkuar min . 7.5 Ton - E ndryshuar në 7.5 Ton (Reale 6 Ton) c. Fuqia e Motorit – E kërkuar 200 Hp – E ndryshuar ne 201 hp (150 Kw) – (Reale 150 Hp apo 112 Kw) d. Cilindrat e motorit – e kërkuar 5-6 L – E ndryshuar në 5.020 L (Reale 3.8

L).

18. Të gjitha këto pretendime tona si palë Ankuese, Autoriteti Kontraktues janë të verifikushme në linqe zyrtare të prodhuesve të cilat janë dokumente autentike dhe të besueshme, andaj ju lutem referojuni linqeve si në vijim për modelin e caktuar: a. https://commercial.otokar.com.tr/OtokarTicari/media/OtokarTicari/kamyon/atlas-3d/atlas-2022-(8-5t-12t).pdf b. https://www.fordtrucks.com.tr/Uploads/Foy/ford_1833-dc_eng_euro6-s8X4WrMm.pdf

19. Prandaj, duke marrë parasysh ndryshimet e shumta materiale në mes të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Ofertës së parashtruar nga ky operator, i kërkojmë OSHP-së që verifikimin e saktësisë së produkteve ta verifikoj me prodhuesin, pasi operatori vet nuk ka dhënë asnjë sqarim se si është e mundur të dalloj katalogu i prodhuesit me atë të ofertës së dorëzuar tek Autoriteti Kontraktues.

20. Të gjitha këto informata kanë qenë të ditura për Autoritetin Kontraktues në fazën e rivlerësimit, por janë injoruar nga Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve, gjë që ka rezultuar në rekomandim të një oferte me produkte të cilat nuk plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit.

IV. OPERATORI TJETËR NUK PLOTËSON KRITERET PËR QARKULLIMIN NË NATYRË TË KONTRATËS

21. Nga qasja në dokumentet e operatorit Haxhijaha kemi vërejtur se i njëjti nuk plotëson as për së afërmi kriterin për qarkullim specifik në vlerë prej 2,000,000 Euro. Nga 22 (me fjalë: njëzetë e dy) referenca për kontrata të ngjashme që i ka dorëzuar, vetëm katër mund të konsiderohen si kontrata të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit. Të gjitha kontratat e tjera janë për mekanizma bujqësor si traktor, motokultivator, bateri dhe produkte bujqësore që nuk kanë të bëjnë asgjë me këtë natyrë të përcaktuar në aktivitetin e prokurimit për produkte të pastrimit apo të mbledhjes së mbeturinave.

22. Nëse kalkulohet vlera e këtyre 4 (me fjalë: katër) kontratave, atëherë shihet se ky operator nuk mbulon as gjysmën e vlerës së qarkullimit që kërkohet me Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht duke pasur në konsideratë këtë fakt, Autoriteti Kontraktues do të duhej që këtë ofertë ta eliminoj si të papërgjegjshme, për shkak të mos plotësimit të kriterit "Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nr. I neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional 1." në të cilin ishte kërkuar si në vijim: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjajshme me vlere minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë."

23. Meqë kjo ofertë nuk plotëson kriteret e përcaktuara në Dosje të Tenderit për shkak të referencave jo adekuate, komisioni për rivlerësimin e ofertave është dashur që të njëjtën ta trajtoj si ofertë të papërgjegjshme, pasi që nuk ka plotësuar kushtin ligjor siç përcaktohet në Nenin 68 [Gjendja Ekonomike dhe Financiare] të Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë, në të cilin thuhet: "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare. Kur përveç qarkullimit

minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës"

24. Duke mos e eliminuar ofertën e operatorit ekonomik NPT Haxhijaha ShPK, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 [Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve] ku thuhet: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit[...]" Prandaj, kjo mangësi e rivlerësimit të ofertave duhet të korrektohet nga OSHP, e cila këtë ofertë duhet ta trajtoj si ofertë të papërgjegjshme. 25. Deklarata nën betim e nënshkruar nga anëtari i konsorciumit Kosova Motors JSC është e nënshkruar nga personi pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare Neni 109 [Autorizimi i Drejtorit Menaxhues për të Vepruar në Emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar]. Andaj, duke marrë për bazë të gjitha argumentet dhe provat e dorëzuara me këtë Kërkesë për Rishqyrtim me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit, që pas shqyrtimit të Ankesës të nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e operatorit ekonomik VIBTIS Dega në Kosovë të cilën sipas Autorizimit e përfaqëson Avokati Isuf Zejna me seli në Rrugën Fehmi Agani Nr. 138/5, Prishtinë, kurse vendimi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Autoritetin Kontraktues Komuna e Prishtinës" me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1 **ANULOHET**, dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP

III. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KRITERET PËR VLERËSIM

**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

*Kërkesa*

Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 3,000,000.00 €.

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

1.Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

**Kapaciteti teknik dhe professional**

*Kërkesa*

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjajshme me vlere minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri ) vitet e fundit,duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë.

2.OE duhet te dorezoj nje autorizim nga prodhuesit të mjetit bazë (ose përfaqësuesit të autorizuar)

3.OE duhet te dorezoj nje vërtetim te karakteristikave teknike të kërkuara të mjetit (shasisë

4.OE duhet te dorezoj nje autorizim apo konfirmimi i prodhuesit të superstrukturës

(Sqarim: Superstrukturë ose mbindërtimi eshte pjesa e kamionit qe vendoset mbi shasine e kamionit qe permbane elementet per bartjen e mbeturinave, tekniken ne pjesen e prapme per manipulim ngarkim -shkarkim te kontejnereve, etj.) permbane elementet per bartjen e mbeturinave, tekniken ne pjesen e prapme per manipulim ngarkim -shkarkim te kontejnereve, etj.)

13.OE duhet te dorëzoj a) Katalogun e shasisë b)Katalogun e superstruktures- mbindërtimit,

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

2.Dëshmia Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi për mjetin bazë me numër të prokurimit publik për këtë procedurë.

3.Vërtetim i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i mjetit (shasisë), me numër të prokurimit publik dhe modelit të mjetit bazë-shasi të ofruar.

4.Autorizimi që përmban sherbimet e dizajnimit, zhvillimimit, prodhimit, shitjes dhe shërbimi pas shitjes të automjeteve dhe pajisjeve komunale

13.Katalogu i nenshruar dhe i vulosur.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vleresimit gjate vleresimit te ofertave konstatoj se per kete projekt , ofertat e tyre i kane dorezuar katër OE, N. P.T. Komisioni konstatoj se oferta e dorezuar nga OE " VIBTIS " DEGA NË KOSOVËN. P.T. eshte e papergjegjshem per shkak se nuk i ka plotesuar kriterin teknik per kontratat e pefunduara ne tri vitet e fundit ne vlere minimale prej 2,000.000.00€, ( ka realizuar kontrata ne vlere prej 1,903.196.70€), Ndersa, OE Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; PORTOFIN d.o.o., eshte e pergjegjshme por, nuk ka ofertuar me çmimin me te lire. OE N. P.T. " Haxhijaha" eshte e pergjegjshme por, nuk ka ofertuar me çmimin me te lire.Andaj, komisioni vendosi qe me kontrate per „Furnizim me pajisje per pastrimin e kryeqytetit ", te REKOMADOJ, OE Grup i Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; KOSOVA MOTORS J.S.C. eshte ofertues i pergjegjshem me çmimin me te lire ne vlere prej 1,250,800.00 EUR.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me qëllim të verifikimit të pretendimit për ndërhyrje në katalogët e prodhuesit, OSHP me datë 05.12.2023 ka kërkuar nga prodhuesi "Otokar Otomotiv ve Savunma Sanayi A.S" që të informojnë OSHP-në se a janë lëshuar broshurat nga prodhuesi dhe a korrespondojnë specifikimet teknike të prodhuesit me ato të paraqitura në broshurat e GOE të rekomanduar për kontratë. Prodhuesit i është dërguar broshura e dorëzuar nga GOE të rekomanduar për kontratë.

Me datë 06.12.2023 është pranuar emaili nga z.Ali YILDIZ, Menaxher Rajonal i Shitjeve Ndërkombëtare të Kamionëve në "Otokar Otomotiv ve Savunma Sanayi A.S". Në email shënohet "*Të dhënat në katalogun që keni dërguar nuk janë të sakta. Ky katalog është manipuluar dhe nuk është lëshuar nga ne. Ne po ju dërgojmë katalogun e saktë të automjetit si bashkëngjitje."*

Katalogu i dërguar me email nga prodhuesi "Otokar Otomotiv ve Savunma Sanayi A.S" është i njëjtë me katalogun që gjendet në faqen e internetit të prodhuesit dhe sikurse është evidentuar me sipër konstatohet së paku 10 pozicione janë manipuluar të dhënat në katalogun e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar.

Poashtu me datë 06.12.2023 OSHP ka kërkuar nga prodhuesi "Ford Otomotiv Sanayi A.S." që të informojnë OSHP-në se a janë lëshuar broshurat nga prodhuesi dhe a korrespondojnë specifikimet teknike të prodhuesit me ato të paraqitura në broshurat e GOE të rekomanduar për kontratë. Prodhuesit i është dërguar broshura e dorëzuar nga GOE të rekomanduar për kontratë.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" VIBTIS " DEGA NË KOSOVË**

**Sqarim hyrës**:

OE ankues me datë 01.11.2023 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK ndaj njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 27.10.2023 ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE-ve: "D&T Group" SH.P.K.; KOSOVA MOTORS J.S.C.. Me datë 06.11.2023 AK ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

**Pretendimi ankimor 1**

OE ankues pretendon se vendimi i AK-së për eliminimin e tenderit të OE ankues me arsyetimin e mosplotësimit të kërkesës së kapacitetit Teknik dhe profesional për kontrata të kësaj natyre, ose të ngjashme me vlere minimale prej 2,000,000.00, është pabazuar.

**Rrethanat e çështjes**

AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 27.10.2023 ka njoftuar OE ankues për eliminimin nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin: - OE "Vibtis" dega ne Kosovë se ofertën e tij të dorëzuar, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale numër 1 neni 9.1 dhe 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1 sipas kontratave te dorëzuara me referenca nuk arrin vlerën e kërkuar prej 2,000,000.00 euro sipas kërkesës ne dosjen e tenderit, por ka vlerën 1,903,196.70 euro andaj i njëjti është i papërgjegjshëm.

Si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues me datë 01.11.2023, ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimin si vijon: "*Autoriteti kontraktues nuk është treguar i kujdesshëm për të vlerësuar ofertat sipas të dhënave në dokumentet e shqyrtuara, pasi që ka injoruar faktin se të dhënat për qarkullimin janë pa përfshirë Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (tutje referuar si: TVSH), gjë e cila është rregull e përgjithshme në procedurat e prokurimit kudo në Europë, pasi që kërkesat e Direktivës 2014/24 kërkojnë që ofertat në prokurim publik të dorëzohen pa TVSH. Në anën tjetër, në Kosovë sipas Ligjit të*

*aplikueshëm për Prokurimin Publik, çmimet e kontratave dhe ofertat dorëzohen duke përfshirë TVSH-në. Kjo krijon ndonjëherë keqkuptime dhe/apo keqinterpretime në shqyrtimin e dokumentacionit sa i përket qarkullimit dhe qarkullimit specifik të operatorëve ekonomik siç është rasti i kësaj ankese, ku Komuna e Prishtinës nuk ka marrë për bazë normën prej 20% të TVSH-së e cila aplikohet në Shqipëri.*"

AK me datë 06.11.2023, ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku lidhur me pretendimin për eliminimin e OE ankues ka dhënë arsyetim: *Nga aneksi 6 i plotesuar nga parashtruesi sikurse me siper, mund te verehet se per kontraten e pare nuk ka qene vetem parashtruesi si pale e kontraktuar por ka qene edhe nje operator tjeter ekonomik. Ne fakt, sa i perket kontrates se pare si deshmi dokumentare parashtruesi ka dorezuar edhe nje formular te vleresimit nga autoriteti perkates kontraktues ku thuhet se parashtruesi "Vibtis" Sh.P.K. ka realizuar vetem 35% te puneve te percaktuara me kete kontrate. Nese nisemi nga ky fakt mund te konfirmohet po ashtu se parashtruesi eshte paguar vetem per 35% te vleres se pergjithshme te kontrates (per aq pune sa ka kryer). Tutje permes te njejtit formular te vleresimit eshte percaktuar se vlera e pergjithshme e kontrates eshte 3,668,309.41 euro. Kjo nenkupton qe vlera e kontrates sipas participimit per parashtruesin eshte 1,283,908.29 euro. Nese kesaj i shtohet edhe vlera e kontrates se dyte qe eshte evidentuar ne aneksin 6 atehere vlera e pergjithshme e kontratave sipas aneksin6 arrihet gjithsej 1,903,196.87 euro (vlera e pergjithshme- bruto). Kjo vlere eshte vlere e pergjithshme (bruto) e percaktuar si e tille permes deshmive dokumentare qe ka dorezuar parashtruesi (pra nuk behet fjale per shuma neto sikurse pretendon parashtruesi). Mbi te gjitha kjo shume e pergjithshme - bruto eshte dukshem me e vogel se vlera prej 2,000,000.00 euro qe eshte kerkuar permes dosjes se tenderit. Ne kete menyre eshte gjetur se ky pretendim ankimor i parashtruesit eshte i pabazuar. Andaj, sipas fakteve dhe provave shkresore të paraqitura mesipër,*

AK në dosjen e tenderit tek kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën: "*1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjashme me vlere minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri ) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë*". Si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesë është kërkuar: "*1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.*"

OE ankues ka dorëzuar listën e kontratave, ku janë paraqitur dy kontrata:

Kontratën me numër rendor 1, me titull: *Procurement of Equipment for Collection and transport of municipal waste and Procurement of Street Sweeping Equipment for Vlora and Selenica Municipalities, Albania*, me date të nënshkrimit 24.08.2021 dhe date të përfundimit 31.08.2022. Vlera e kontratës është 3,668,309.41-euro dhe shënohet se vlera është pa TVSH. Emri i blerësit është Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime (AKUM) dhe përfituesi final është: Komuna e Vlorës.

Kontratën me numër rendor 2, me titull: *Lot1 – Waste collection and landfill mobile equipment; Lot-3 Landfill basic operation equipment*, me date të nënshkrimit 15.06.2022 dhe date të përfundimit 30.04.2023. Vlera e kontratës është 609,288.58-euro dhe shënohet se vlera është pa TVSH. Emri i blerësit është Korca Regional Waste Management Company (KRWM).

Në lidhje me kontratën numër rendor 1, janë dorëzuar dokumentet si vijon:

Dokumenti "Formular Vlerësimi", i cili mbanë datën 20.01.2023 dhe numrin e protokollit 112. Dokumenti është lëshuar nga Autoriteti kontraktor/Investitor: Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve, dhe Infrastruktures se Mbetjeve, konkretisht Administratori: Klevis Jahaj: në të cilën shënohet: VERTETOJ SE: Autoriteti kontraktor/ investitori ka nenshkruar me: bashkimin e Operatoreve Ekonomik JV Alb-Star Sh.p.k Nuis J62903512W & Vibtis Sh.p.k Nuis L02103503S kontraten : BMZ-No.: 201667906 date 24.08.2021, objekti i kontrates: "Procurement of Equipment for collection and transport of municipal waste and Procurement of Street Sweeping Equipment for Vlora and Selenica Municipalities, Albania, Data e Fillimit te Kontrates 24.08.2021, Data e mbarimit te kontrates 31.08.2022, Vlera Sipas Kontrates : 3668309.41 Eur (tre million e gjashteqind e gjashtedhjete e tete mije e treqind e nente euro pike dyzet e nje, Vlera e realizuar: 3668309.41 Eur (tre million e gjashteqind e gjashtedhjete e tete mije e treqind e nente euro pike dyzet e nje, % e bashkimit te O.E dhe pershkrimi i puneve te kryera nga secili anetar-65% Operatori Ekonomik Alb-Star Sh.p.k 35% Operatori Ekonomik Vibtis Sh.p.k. Vleresimi-i perrnbushur. Dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur.

Poashtu është dorëzuar Kontrata e cila mbanë datës 24.08.2021 e lidhur në mes të AKUM dhe ALB-STAR sh.p.k. & VIBTIS sh.p.k, në të cilën shënohet se vlera e kontratës është 619,288.58. Kontrata është e nënshkruar dhe vulosur nga palët

Është dorëzuar edhe dokumenti me titullin Shtojcë Nr.1 e Kontratës në të cilën shënohet: Me këtë shtojcë janë përfshirë pikat opsionale në objektin e kontratës, në përputhje me Takimin e Negocimit të Kontratës, pjesën c) të Marrëveshjes së Kontratës - tabela 2 seksioni 1.1. Me inkorporimin e njësive opsionale, çmimi i kontratës për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në shumën prej 3,459,245.1 euro (njësi të detyrueshëm) rritet për 209,064,31 euro me shumën totale prej 3,668,309,41 euro. Dokumenti është nënshkruar nga palët.

Në fund janë dorëzuar faturat elektronike nga Platforma Qendrore e Faturave e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Republikës së Shqipërisë. Faturat e dorëzuara kanë këto të dhëna: Shitësi është VIBTIS, dhe blerësi apo klienti është Bashkia Vlorë. Faturat janë si në vijim:

673/2022 e lëshuar me datë 20.05.2022 në shumë totale prej 663 697.09 euro me tvsh;

690/2022 e lëshuar me datë 20.05.2022 në shumë totale prej 458 782,08 euro me tvsh;

687/2022 e lëshuar me datë 20.05.2022 në shumë totale prej 126 643.44 euro me tvsh;

750/2022 e lëshuar me datë 31.05.2022 në shumë totale prej 183 512,83 euro me tvsh;

676/2022 e lëshuar me datë 20.05.2022 në shumë totale prej 131 976.56 euro me tvsh;

682/2022 e lëshuar me datë 20.05.2022 në shumë totale prej 146 685.50 euro me tvsh;

679/2022 e lëshuar me datë 20.05.2022 në shumë totale prej 122 573.28 euro me tvsh;

1027/2022 e lëshuar me datë 02.08.2022 në shumë totale prej 111 312,91 euro me tvsh;

1028/2022 e lëshuar me datë 02.08.2022 në shumë totale prej 179 882,27 euro me tvsh;

1029/2022 e lëshuar me datë 02.08.2022 në shumë totale prej 185 725,90 euro me tvsh;

1030/2022 e lëshuar me datë 02.08.2022 në shumë totale prej 273 623,71 euro me tvsh;

1133/2022 e lëshuar me datë 25.08.2022 në shumë totale prej 79 333,56 euro me tvsh;

1173/2022 e lëshuar me datë 07.09.2022 në shumë totale prej 67 037,81 euro me tvsh;

1169/2022 e lëshuar me datë 07.09.2022 në shumë totale prej 181 801,67 euro me tvsh;

Në lidhje me kontratën numër rendor 2, janë dorëzuar dokumentet si vijon:

Certifikata përfundimtare e pranimit, e lëshuar nga KRWM cila mbanë datën 30.04.2023 ku evidentohet se janë paguar 609,288.58 euro pa TVSH. Dokumenti është nënshkruar nga Nikolin Balli, Menaxher i Përgjithshëm në KRWM dhe është i vulosur me vulën e KRWM.

Poashtu është dorëzuar Kontrata e cila mbanë datës 16.06.2022 e lidhur në mes të Korça Regional Waste Management Company (KRWM) dhe Vibtis, në të cilën shënohet se vlera e kontratës është 619,288.58. Kontrata është e nënshkruar dhe vulosur nga palët.

Është dorëzuar edhe dokumenti Letër e Pranimit e cila mbanë datën 15.06.2022 në të cilën shënohet: me këtë ju njoftojmë se oferta juaj e datës 09.12.2021 për prokurimin e mallrave: Loti 1 - pajisje mobile për grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve; Loti 3 - pajisjet bazë të funksionimit të landfillit, siç është korrigjuar dhe modifikuar në përputhje me udhëzimet për ofertuesit pranohet nga Blerësi i poshtëshënuar. Ju kërkohet të jepni Sigurimin e Performancës brenda njëzet e tetë (28) ditësh në përputhje me Kushtet e Kontratës duke përdorur për këtë qëllim Formularin e Sigurisë së Ekzekutimit të përfshirë në seksionin Kushtet X, Kontrata e Kontratës, Formularët, të Dokumenteve të detyrueshme. Dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur KRWM.

Në fund është dorëzuar edhe dokumenti me titullin Shtojcë Nr.1 e Kontratës në të cilën shënohet: "*Çmimi i kontratës për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 619,288,58 euro është ulur në 609,288,58 si rezultat i ndryshimit të shasisë së markës për pikën 1.1 LOT 1, automjet për grumbullimin e mbeturinave 8m2.*"

**Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor numër 1**

Eksperti sqaron se AK gjatë vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve nuk ka trajtuar të gjithat informatat në dispozicion në provat shkresore të dorëzuara nga OE ankues, si dëshmi për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional. Kjo, për faktin se në listën e kontratave është paraqitur qartësisht se vlerat janë pa TVSH dhe se AK nuk ka bërë shqyrtimin e dëshmive që janë bashkangjitur me kontrata sikurse janë katërmbëdhjetë faturat tatimore, ku qartësisht janë prezantuar vlerat me TVSH. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 2**

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar Grupin e OE-ve i cili nuk plotëson kërkesën numër 12 të kapacitetit teknik dhe profesional.

**Rrethanat e çështjes**

AK në dosjen e tenderit tek kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën *12.Të gjitha automjetet e ofruara (shasi) të prodhuara nga i njëjti prodhues*. Dëshmia e kërkuar dokumentare është *12.Deklaratë nga prodhuesi se të gjitha automjetet e ofruara (shasi) prodhohen nga i njëjti.*

Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë sipas broshurave të dorëzuara ka ofertuar me makineritë: "Otokar Atlas 8.5t -12t" dhe "Ford Truck 1833 DC 12".

Grupi i OE-ve ka dorëzuar autorizimet si vijon: Dokumentin "Konfirmim" të lëshuar nga "Ford Central and Eastern Europe", me datë 18.08.2020. Më tej është dorëzuar autorizimi nga "Albania Motor Company" për anëtarin e grupit "D&T Group" Sh.P.K.

Ford Truck 1833 DC 12 është makineri e prodhuar nga Ford Otosan me seli në Turqi, me aksionar Ford Motor Company (41%) dhe Koç Holding A.S. (41%) si dhe aksione në tregtim (18%) .

Poashtu, është dorëzuar edhe autorizimi i "Otokar Otomotiv Ve Savunma Sanayi A.S". për subjektin "My Dealer" me adresë në Shkup, Maqedonia Veriore. Pastaj "My Dealer" ka autorizuar anëtarin e grupit "D&T Group" SH.P.K.

Otokar Atlas 8.5t -12t është makineri e prodhuar nga "Otokar Otomotiv Ve Savunma Sanayi A.S", me aksionar Koç Holding A.S. (45%) Ünver Holding A.S. (25%) dhe të tjerë (30%).

Në katalogun e dorëzuar për makinerinë Otokar Atlas 8.5t -12t nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë, në faqen e parë është vendosur shenja e prodhuesit "Ford". Përderisa, sipas sqarimit të pranuar nga prodhuesi "Otokar Otomotiv Ve Savunma Sanayi A.S", përkatësisht në katalogun e pranuar nga prodhuesi nuk figuron shenja e prodhuesi "Ford".

**Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor numër 2**

Eksperti sqaron se makineritë e ofertuara ("Otokar Atlas 8.5t -12t" dhe "Ford Truck 1833 DC 12".) nga Grupi i OE të rekomanduar për kontratë i takojnë dy prodhuesve të ndryshëm, rrjedhimisht nuk është plotësuar kërkesa numër 12 e kapacitetit teknik dhe profesional e përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 3**

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke rekomanduar Grupin e OE-ve i cili ka dorëzuar katalog me të dhëna të pasakta dhe të cilat dallojnë nga të dhënat e prodhuesit.

**Rrethanat e çështjes**

AK në dosjen e tenderit tek kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar

kërkesën: 13.OE duhet te dorëzoj a)Katalogun e shasisë b)Katalogun e superstruktures-mbindërtimit. Dëshmia dokumentare për këtë kerkesë është kërkuar: 13.Katalogu i nënshkruar dhe i vulosur.

AK në dosjen e tenderit përkatësisht në aneksin 1 specifikacionet teknike të detyrueshme në dy pozicione.

OE ankues me datë 01.11.2023, ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet e njëjta në lidhje me ndryshimin e specifikimeve teknike të Grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë.

AK me datë 06.11.2023, ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku nuk e ka trajtuar fare pretendimin e mësipërm.

Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar broshurat si vijon: broshurën e "Otokar Atlas 8.5t -12t", dhe broshurën e "Ford Trucks 1833 DC".

Eksperti gjatë kontrollit të dy broshurave fillimisht vëren se në të dy broshurat kanë ndërhyrje në përmbajtje të evidentuara si komente nga përdoruesit/pajisjet me emërtim "DT-2" dhe "AutoCADSHX Txt" të cilat janë bërë me datë 05.09.2023.

Më tej janë krahasuar broshurat e prodhuesve me ato të dorëzuara nga Grupi i OE-ve.

Broshura e "Ford Trucks 1833 DC"e cila është e qasshme në adresën në internet: https://www.fordtrucks.com.tr/Uploads/Foy/ford_1833-dc_eng_euro6-s8X4WrMm.pdf , ka disa dallime me broshurën e dorëzuar nga GOE të cilat janë paraqitur në tabelën si vijon:

| | Specifikimet | Specifikat sipas broshurës së dorëzuar nga GOE | Specifikat sipas broshurës në faqen e prodhuesit në internet |
|---|---|---|---|
| 1 | Wheelbase (mm) | 4300 | 4250 |
| 2 | Engine Type: | Ecotorq 8 liters 6 cyl | Ecotorq 9 liters |
| 3 | Displacement (cc) | 7974 | 8974 |
| 4 | Manuel Transmission / Ratios (1. gear - 9. gear) | 6+1 Speed (6.40-0,75) | 9+1 Speed (9,40 - 0,75) |
| 5 | Fuel Tank | 350 L Plastic | 350 L Aluminium |
| 6 | SCR Tank +Adblue Tank | 55 L+30L Plastic | SCR Tank 55 L |
| 7 | Technically Permissible Weights 2Axle | 11600 | 12600 |

Broshura e "Otokar Atlas 8.5t -12t" e cila është e qasshme në internet në adresën: https://commercial.otokar.com.tr/OtokarTicari/media/Otokar-Ticari/kamyon/atlas-3d/ATLAS-2023-(8,5t-12t)-ok-montaj-EN-(Avrupa)-TK04EE-23-onizleme-(1)_1.pdf ka disa dallime me broshurën e dorëzuar nga GOE. Dallimet janë këto:

| | Specifikimet | Specifikat sipas broshurës së dorëzuar nga GOE | Specifikat sipas broshurës në faqen e prodhuesit në internet |
|---|---|---|---|
| 1 | Wheelbase | 3400 | 3360 |
| 2 | Technically permissible maximum mass on front axle | 4000 | 3000 |
| 3 | Technically permissible maximum mass on rear axle | 7500 | 6000 |
| 4 | Engine type | Diesel Euro6 SCR Particular Filter EGR | Cummins Intercooler Turbo Diesel Euro6 |
| 5 | Engine Displacement | 5020 cm3 | 3800 cm3 |
| 6 | Max. Net Power | 150 kW @ 2600 rpm | 112 kW @ 2600 rpm |
| 7 | Max. Net Torque | 800 Nm @ 1600-1800 rpm | 534 Nm @ 1600-1800 rpm |
| 8 | SUSPENSION<br><br>Front and Rear Suspension | Layered parabolic suspension AIr on rear axle with two air bellows | Leaf spring Double effective shock absorbers Anti roll bar |
| 9 | Fuel Tank capacity (lt.) | 120 Plastic | 120 |
| 10 | Adblue Tank capacity (lt.) : | 30 Plastic | 30 |

Me qëllim të verifikimit të pretendimit për ndërhyrje në katalogët e prodhuesit, OSHP me datë 05.12.2023 ka kërkuar nga prodhuesi "Otokar Otomotiv ve Savunma Sanayi A.S" që të informojnë OSHP-në se a janë lëshuar broshurat nga prodhuesi dhe a korrespondojnë specifikimet teknike të prodhuesit me ato të paraqitura në broshurat e GOE të rekomanduar për kontratë. Prodhuesit i është dërguar broshura e dorëzuar nga GOE të rekomanduar për kontratë.

Me datë 06.12.2023 është pranuar emaili nga Menaxheri Rajonal i Shitjeve Ndërkombëtare të Kamionëve në "Otokar Otomotiv ve Savunma Sanayi A.S". Në email shënohet "*Të dhënat në katalogun që keni dërguar nuk janë të sakta. Ky katalog është manipuluar dhe nuk është lëshuar nga ne. Ne po ju dërgojmë katalogun e saktë të automjetit si bashkëngjitje.*"

Katalogu i dërguar me email nga prodhuesi "Otokar Otomotiv ve Savunma Sanayi A.S" është i njëjtë me katalogun që gjendet në faqen e internetit të prodhuesit dhe sikurse është evidentuar me sipër konstatohet së paku 10 pozicione janë manipuluar të dhënat në katalogun e dorëzuar nga Grupi i OE-ve të rekomanduar.

Poashtu me datë 06.12.2023 OSHP ka kërkuar nga prodhuesi "Ford Otomotiv Sanayi A.S." që të informojnë OSHP-në se a janë lëshuar broshurat nga prodhuesi dhe a korrespondojnë specifikimet teknike të prodhuesit me ato të paraqitura në broshurat e GOE të rekomanduar për kontratë. Prodhuesit i është dërguar broshura e dorëzuar nga GOE të rekomanduar për kontratë. Megjithatë, deri në dorëzimin e këtij raporti nuk është pranuar përgjigje.

**Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor numër 3**

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar për faktin se Grupi i OE-ve të rekomanduar kanë dorëzuar një dokument të rremë me të dhëna të manipuluara.

**Pretendimi ankimor 4**

OE ankues, në fund pretendon se anëtari "Kosova Motors JSC" i GOE ka dorëzuar deklaratën nën betim e cila nuk është nënshkruar nga personi i autorizuar.

**Rrethanat e çështjes**

Grup i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë përbëhet nga anëtarët përkatësisht OE " D & T Group SH.P.K."; "Kosova Motors J.S.C.,"

Deklarata nën betim për anëtarin e grupit "Kosova Motors J.S.C.," është nënshkruar nga z.Valdrin Manaj, me pozicion Menaxher i Shitjes.

Në lidhje me anëtarin "Kosova Motors J.S.C.," është dorëzuar certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me numër fiskal: 600385547 dhe numri unik identifikues: 811277591. Në ekstraktin me informata mbi biznesin të dorëzuar nuk evidentohet se z.Valdrin Manaj është person i autorizuar i kompanisë.

Eksperti ka verifikuar informacionet për kompaninë "Kosova Motors J.S.C" në ueb faqen e ARBK-së dhe rezulton se i vetmi person i autorizuar është z.Nehat Hoxha.

Eksperti sqaron se në lidhje me Deklaratën nën betim, KRPP ka dhënë opinionin numër 14 me datë 24.10.2023, lidhur me pyetjen: "*A mund të nënshkruhen Deklarata nën betim dhe dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar ?*"

KRPP është përgjigjur: "*Konform nenit 87, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së autorizimit, KRPP sqaron se çështja për të autorizuar një person që të nënshkruaj Deklaratën nën Betim dhe ose dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik nuk rregullohet me dispozita të LPP dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë. Çështja e autorizimit rregullohet me ligje tjera në fuqi në Republikën e Kosovës. Megjithatë, opinioni i KRPP-së është si në vijim: Për derisa në Formularët Standard të Dosjes së Tenderit përfshirë "Deklaratën nën Betim" dhe dokumentet tjera (Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, Kërkesa për Sqarim, Formulari i Tenderit etj) në të cilat kërkohen të dhënat mbi identifikimin e përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik (Emri dhe Mbiemri, pozita, nënshkrimi, data dhe vula), pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i*

*Operatorit Ekonomik, rrjedhimisht të njëjtat dokumente nuk mund të nënshkruhen nga një person tjetër jo kompetent apo që nuk ka autorizim për të nënshkruar dokumentet në fjalë. Në pamundësi të nënshkrimit të dokumenteve në fjalë nga përfaqësuesi i operatorit Ekonomik, i njëjti mund të veprojë sipas rregullave mbi autorizimin të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.*"

**Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor numër 4**

Eksperti sqaron se në tenderin e Grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë nuk është dorëzuar autorizim përmes të cilit personi z.Valdrin Manaj autorizohet për të nënshkruar dokumentet në fjalë. Andaj, në ndërlidhje me sqarimet e mësipërme, pretendimi ankimor është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 5**

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke vlerësuar se OE "Haxhijaha" ka dorëzuar tender të përgjegjshëm përkundër që nuk plotëson kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional.

**Rrethanat e çështjes**

AK në dosjen e tenderit tek kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën: "*1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjashme me vlere minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri ) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë*". Si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesë është kërkuar: "1.*Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.*"

OE ankues ka dorëzuar listën e kontratave, ku janë paraqitur njëzet e dy (22) kontrata me.

| Nr. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Blerësi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnizim i kamionit për mbartjen e mbeturinave | 07.07.2022 | 07.10.2022 | 89,700.00 | Kuvendi Komunal Ranillug |
| 2 | Furnizim me pajisje bujqësore | 18.11.2022 | 18.12.2022 | 89,270.00 | Komuna e Gjakovës |
| 3 | Furnizim me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim | 14.10.2022 | 14.12.2022 | 162,000.00 | Komuna e Prizrenit |
| 4 | Blerja e një traktori për pastrimin e bores ne K.K. Dragash | 02.09.2022 | 02.10.2022 | 29,999.00 | Komuna e Dragashit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Furnizimi me materiale për përgatitjen e festivalit te XIV te domates, pajisje bujqësore dhe pajisje te ndërtimtarisë | 20.07 .2022 | 20.08.2022 | 76,989.83 | Komuna e Mamushes |
| 6 | Furnizim me pajisje te nevojshme për Njësinë Ekonomike te SHKK-se | 19.05.2022 | 30.06.2022 | 39,920.00 | Shërbimi korrektues Kosovës |
| 7 | Furnizim me pajisje bujqësore-Motokultivator | 23.12.2022 | 23.01.2023 | 22,500.00 | Komuna Gjakovës |
| 8 | Furnizim me Mekanizëm Bujqësor, Motokultivator, Spërkatëse, Shpërndarëse plehut | 21.11.2022 | 21.12.2022 | 81,762.00 | Komuna Suhareke |
| 9 | Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermer me participim 80%-20% | 22.03.2022 | 22.03.2023 | 353,100.00 | Komuna e Rahovecit |
| 10 | Skema mbështetëse për mbeturina ne Kosove - Furnizim me kamion, autofshisa dhe kontejner | 12.08.2022 | 12.06 .2023 | 666,000.00 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| 11 | Furnizim me mekanizëm bujqësor | 01.01.2020 | 31.12.2022 | 75,949.00 | HELP - Hilfe zur Selbsthllfe |
| 12 | Furnizim me mekanizëm bujqësor | 29.07 .2020 | 22.06 .2023 | 269,452.50 | Iniciativa për zhvillimin e bujqësisë se Kosovës - IADK |
| 13 | Furnizim me 77 shpërndarëse plehut 350L(për traktor) për bujqit përfitues te komunës se Skenderajt | 05.05.2021 | 30.05 .2021 | 13,013.00 | Komuna e Skenderajit |
| 14 | Furnizim me kamion për mbeturina | 18.02.2021 | 08.06.2021 | 67,965.00 | Pastrimi Sh.A. |
| 15 | Furnizim me 30cope bateri për autobusë | 21.09.2021 | 30.09.2021 | 4,590.00 | Trafiku Urban Prishtine |
| 16 | Furnizim me pajisje bujqësore për festivalin XIII te domates | 12.08.2021 | 30.08.2021 | 69,890.00 | Komuna e Mamushës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Furnizim me mekanizëm bujqësore me participim | 24.05.202 1 | 30.08.2021 | 185,425.00 | Komuna e Prizrenit |
| 18 | Furnizim me pajisje për Njësinë Ekonomike | 28.09.2021 | 15.11.2021 | 33,080.00 | Shërbimi korrektues i Kosovës |
| 19 | Furnizim me mekanizëm bujqësore | 15.06.2021 | 15.08.2021 | 120,930.00 | Komuna e Malishevës |
| 20 | Furnizim me pajisje bujqësore për fermeren Marigona Bytyqi nga Fshati Turjake | 16.09.2021 | 16.10.2021 | 8,940.00 | Komuna e Malishevës |
| 21 | Furnizim me mekanizëm bujqësor | 16.09.202 1 | 30.09.2021 | 11,160.00 | Komuna e Malishevës |
| 22 | Furnizim me motor te ri për traktor (tipi tiger 35). Njësia Operative Prizren | 11.08.2021 | 11.09.2021 | 3,840.00 | Kompania regjionale e mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A. Prizren |

Eksperti sqaron se në lidhje me formulimin kontrata të ngjashme, KRPP ka dhënë opinionin numër 11 me datë 09.06.2023, si vijon: *Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë: OPINION: Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj. Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme. Në kuptim të prokurimit publik: Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e* një *furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës. Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi " Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së). Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme". Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para. Sa i përket pyetjes së parashtruar*

*nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.*

AK me datë 06.11.2023, ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku nuk e ka trajtuar fare pretendimin e mësipërm.

**Vlerësimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor numër 5**

Eksperti sqaron se duke u nisur nga kërkesa e AK-së dhe në ndërlidhje me opinionin e mësipërm të KRPP-së, përcaktimi për kontrata të ngjashme është kompetencë e AK-së, përkatësisht njësisë kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, të përcaktojnë cilat janë kontrata të ngjashme. Megjithatë, me qëllim të vlerësimit objektiv, në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe RrPP-së, përveç aktivitetet që janë të kësaj natyre ku mund të vlerësohet që përfshihen kamion për mbeturina, dhe aktivitet që përfshijnë furnizime me mjete sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, AK mund të marrë për bazë kodet e fjalorit të përgjithshëm të prokurimit publik për kontratat publike. Si dhe në rastet kur kontratat nuk janë të natyrës së njëjtë dhe nuk aplikohen kodet e FPP-së, gjatë vlerësimit të shpjegohen ngjashmëritë e konstatuar nga AK në mes të lëndës së këtij aktiviteti dhe furnizimeve të përfshira në listën e kontratave të dorëzuara nga OE si dështmi për kontrata të ngjashme. Andaj, sipas sqarimeve pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar dhe eksperti rekomandon OSHP-së që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit, AK të marrë për bazë sqarimin e mësipërm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" VIBTIS " DEGA NË KOSOVË**

**Kreshnik Spahiu**